



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2912 Prot.

Lezhë, më 04 . 03 . 2024

VENDIM

Nr. 18, Datë 29. 02. 2024

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", VKM-në nr. 433, datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684, datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive", VKM-në nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar, në udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, date 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", në udhëzimin nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit, "Përmbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar", bazuar në kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme për marrje toke pyjore në përdorim, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **8 ha** e përbërë nga sheshet e Aerogjeneratorëve dhe sipërfaqe ndihmëse që shtrihet nën helikat e Aerogjeneratorëve + **5.25 ha** sipërfaqe e rrugës me **7.62 km** gjatësi + **2.13 ha** për linjën elektrike me **3.51 km** gjatësi, që mund të jepet në përdorim dhe shtrihet në ngastrat/nëngastrat: **05b, 06a, 06b, 07c, 08c, 09c, 010e, 011e, 012b, 013d, 014b, 015c, 016d, 017f, 018b, 019d, 020d, 021c, 06b, 07b, 07a, 03d, 03c, 03b**, të cilat bëjnë pjesë në ekonominë pyjore: *Zadrimë* e shtrirë në Njësinë Administrative Blinisht dhe në ngastrat/nëngastrat **81, 80, 78** të cilat bëjnë pjesë në ekonominë pyjore *Brinjat e Kreshtës* e shtrirë në Njësinë Administrative Ungrej, sipas Raportit Teknik, bashkangjitur.
2. Afati për dhënie në përdorim do të jetë 10 vjet me të drejtë rinovimi me të njëjtin afat.

3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse do të jetë **2371410 (Dy milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e dhjetë) lekë në vit**, e detajuar sipas zërave:
- Sipërfaqe pyjore për t'u dhënë në përdorim, **3.1 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Trungishte **X 210000 lekë/ha = 651000 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për t'u dhënë në përdorim, **2.1 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 176000 lekë/ha = 369600 lekë**.
 - Sipërfaqe pyjore për t'u dhënë në përdorim, **2.8 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 143000 lekë/ha = 400400 lekë**.
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **2.68 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Trungishte **X 70000 lekë/km = 187600 lekë**.
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **0.79 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Cungishte **X 50000 lekë/km = 39500 lekë**.
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **1.78 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 35000 lekë/km = 62300 lekë**.
 - Sipërfaqe rruge auto e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **2.37 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 25000 lekë/km = 59250 lekë**.
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **0.27 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Trungishte **X 175000 lekë/km = 47250 lekë**.
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **0.81 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Cungishte **X 145000 lekë/km = 117450 lekë**.
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **2.08 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 145000 lekë/km = 301600 lekë**.
 - Sipërfaqe linje elektrike e shprehur në gjatësi për t'u dhënë në përdorim, **0.35 km** në kategorinë e përdorimit të territorit Inproduktive **X 110000 lekë/km = 38500 lekë**.
 - Vlera e materialit drusor që pritet nga hapja e rrugëve dhe linjës elektrike, dru zjarri **161.6 m³ X 600 lekë/m³ = 96960 lekë**.
4. Të kryejë rehabilitim mjedisor sipas planit të rehabilitimit dhe VNM-së paraprake.
5. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 216/18 Prot.

Lezhë më 07.03.2024

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma“b“të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut“, ligjin nr.139/2015“Për vërtetuesjen vendore“, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar ; ligjin nr. 57/2020 datë 30.04.2020”Për pyjet”;VKM-në nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministries së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive”; VKM-në nr.559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jo drusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre të ndryshuar ; Udhezimin nr.1 date 09.06.2016, të Ministrit të Mjedisit “Për rregullat , procedurat e kërkimit , të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor“ si dhe në Udhezimin nr. 1 date 26.01.2017, të Ministrit të Mjedisit “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullor kombëtar“,konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.18, datë 29.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “ Për dhënie e dakortësisë për vijimin e procedurave për dhënie në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të bashkisë Lezhë , për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet“.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

